



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2021:048735

Datë: 23.01.2024

Numri i dokumentit: 05229282

P.nr.663/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTIË – DEGA FUSHË KOSOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, sipas Gjyqtares Laura Hoti Statovci, në lëndën penale të akuzuarit A. V. nga Fshati M. e E. KK Fushë Kosovë, i akuzuar për veprën penale *Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par. 1.4 të KPRK-së*, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.5337/20 të datë 16.03.2021, në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 18.01.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit Besnik Jakupi dhe të akuzuarit A. V., me datë 18.01.2024 mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datë 23.01.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri A. V., i biri i H. dhe nënës I. e gjinisë M., i lindur më, në P., me vendbanim në M. e E. KK F. K., me nr. personal, shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës, beqar, punëtor në shtyp shkronje, ka kryer shkollë në mesme, i gjendjes së mesme ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 14.10.2020, rreth orës 00:30, në parkingun e banesës “M. S.”, KK Fushe Kosove, pas një mosmarrëveshje paraprake në mes të pandehurit A. V. dhe të dëmtuarit B. E., i pandehuri me dashje që ti shkaktojë lëndime trupore, e sulmon dhe e godet me grushte në pjesë të ndryshme të trupit të dëmtuarin, me çka i shkakton lëndime të lehta trupore, në formë të ndrydhjeve në indet e buta të laprës së veshit të djathtë, gërvishtje lëkurore të parakrahut të dorës së djathtë dhe gjak mbledhje në lëkurore përreth dy syve të fytyrës, me pasojë të përkohshme për shëndetin.

- *Me këtë ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par. 1.4 të KPRK-së.*

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70, 71, 72 dhe 181 PAR 2 të KPRK-së dhe neneve 358, 359, 360 dhe 364 të KPPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

- I. Në shumën prej 500.00 (pesëqind) Euro të cilin dënim i pandehuri obligohet që ta paguaj në afat prej 60 ditëve nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi
- II. Nëse i pandehuri dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar më lartë, atëherë gjykata këtë dënim do ta zëvendësoj me dënim burgu në kohëzgjatje prej 25 (njëzet e pesë) ditësh, duke llogaritur një ditë burgim me 20 (njëzetë) euro të gjobës.
- III. Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguaj shumën prej 20 (njëzet) Euro në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shumën prej 20 (njëzet) Euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 60 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.
- IV. I dëmtuari B. E. nga P. udhëzohet kërkesës pasurore juridike ta realizoj në procedurë civile.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP.II.nr.5337/20 të datë 16.03.2021, ndaj të akuzuarit A. V. për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par. 1.4 të KPRK-së.

Gjykata, në këtë çështje penale juridike ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 18.01.2023, në prani të Prokurorit të Shtetit Besnik Jakupi dhe të pandehurit A. V. ku i njëjti u njoftuan me të drejtat e tij, me aktakuzën dhe provat kundër tij. Pas kësaj prokurori i shtetit lexoj aktakuzën kundër të pandehurit.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i pandehuri u deklarua se e pranojnë fajësinë për veprën penale për të cilat akuzohet sipas aktakuzës.

Pas deklarimit të pandehurit dhe mendimit të prokurorit se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, Gjykata konstatoj se i pandehuri ka pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, i pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248 par. 1 të KPPRK-së janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 357 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 242 par. 6 lidhur me par. 2 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të akuzuarit se e pranojnë fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 6 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit A. V.

qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par. 1.4 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari e ka kryer veprën me dashje, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 të KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për të akuzuarin, gjykata ka vlerësuar faktin se i akuzuari ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor duke pranuar fajësinë, duke u ndier i përgjegjshëm për veprimet e tij dhe duke shpreh keqardhje për veprën që e ka kryer. Të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese në dobi të akuzuarit, ndërsa si rrethana rënduese Gjykata nuk gjeti.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata në kuptim të nenit 43 të KPRK-se të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen veçanërisht llojin e njëjtit të veprës penale, por ai do të ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 38 të KPPRK-se.

Duke u bazuar në nenin 449 par. 2 pika 2.6 dhe 452 par.1 të KPPRK-se si dhe në bazë të nenit 36 par.3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit nr.08/L-109, Gjykata ka vendosur për shpenzimet e procedurës penale në shumën e përgjithshme prej 40 €.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 361 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL
P.nr.663/21 datë 23.01.2024**

Gjyqtarja e vetme Gjyquese

Laura Hoti Statovci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të parashetrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.